



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



RREGULLI PËR KONSUMATORËT PRODHUES

Parimet kryesore

Zyra e Rregullatorit për Energji
Korrik 2022, Prishtinë

KONSUMATORËT PRODHUES NË KUADËR TË SKEMËS SË FATURIMIT NETO

- Të gjithë konsumatorët e regjistruar mund të jenë konsumatorë prodhues
- Të gjithë gjeneratorët për vetë-konsum duhet të jenë të autorizuar nga ZRRE
- Kapaciteti i instaluar i gjeneratorëve për vetë-konsum \leq Kapaciteti i kontraktuar i kyçjes së konsumatorit
- Kapaciteti i instaluar i gjeneratorëve për vetë-konsum \leq Pragu
- Tepërcat e energjisë elektrike të futura në rrjet $<$ Konsumi neto i energjisë elektrike (tërhequr nga rrjeti)
- Furnizuesi (KESCO) duhet të tejkaloj të gjithë energjinë e tepërt nga konsumatorët prodhues në skemën mbështetëse

SKEMA MBËSHTETËSE - PRAGU

- Në procesin e përcaktimit të pragut, ZRRE merr parasysh:
 - **Vendimin strategjik** për numrin e konsumatorëve prodhues që do të mbështeten
 - **Ndikimin** në sigurinë e furnizimit në Kosovë dhe zvogëlimin e varësisë nga importi
 - **Ndikimin** e konsumatorëve prodhues tek konsumatorët e tjerë dhe tek OSSH

SKEMA MBËSHTETËSE E FATURIMIT NETO

- Fatura e lëshuar nga furnizuesi bazohet në vlerën e energjisë së tërhequr të zvogëluar për vlerën e energjisë së tepërt
- Bazë për llogaritjen e tarifave të rrjetit dhe tarifave të energjisë së ripërtëritshme është sasia e energjisë elektrike të tërhequr.
- Konsumatorët prodhues do të marrin dhe kompensojnë vetëm komponentin energjetike të faturës
- Nëse vlera e energjisë së tepërt është më e madhe se vlera e energjisë së tërhequr, konsumatori kreditohet në njësi monetare për periudhën e ardhshme të faturimit.
- Një kredi kalon në periudhën e ardhshme kontabël, brenda një periudhe kompensimi të përcaktuar ([6] muaj)
- Çmimi i energjisë së tepërt të futur në rrjet do të jetë $[0,9]$ x çmimi i shitjes me pakicë (vetëm komponentët e energjisë të çmimit me pakicë)

KONSUMATORËT PRODHUES JASHTË SKEMËS MBËSHTETËSE

- Kapaciteti i instaluar i gjeneratorëve për vetë konsum \leq Kapaciteti i kontraktuar i kyçjes së konsumatorit
- Duhet **autorizuar** nga ZRRE
- Duhet të ketë **një marrëveshje të nënshkruar me furnizuesin** rreth tepricës së energjisë elektrike, ose energjia elektrike e tepruar duhet të jetë **“zero”**
- Çmimi i tepricës së energjisë elektrike dhe kushtet e tjera (kredi monetare, periudha e kompensimit...) do t'i nënshtrohen **negocimit me Furnizuesin** (bazuar në treg)

TARIFA E RRJETIT NË SKEMIN E FATURIMIT NETO

- Konsumatorët prodhues duhet të kontribuojnë në mënyrë **adekuate** në ndarjen e kostos së përgjithshme të rrjetit (sistemit energjetik).
- **Të gjithë konsumatorët prodhues** (konsumatorët prodhues brenda skemës mbështetëse dhe konsumatorët prodhues jashtë skemës mbështetëse) duhet t'u nënshtrohen tarifave të rrjetit
- Një tarifë fikse mujore për shërbimet shtesë të sistemit për konsumatorët prodhues ("**tarifa për konsumatorin prodhues**") që do t'i paguhet OSSH-së (OST)
- **Mbulimi i një pjese të kostove shtesë** që lidhen me futjen e energjisë elektrike në rrjet dhe **zvogëlimin** e ndikimit financiar tek konsumatorët

KONSUMATORËT PRODHUES QË VEPROJNË BASHKARISHT

- Grup i autorizuar (i përfaqësuar nga një person/subjekt i deleguar) prej të paktën dy prodhuesve që veprojnë kolektivisht dhe të vendosur në të njëjtën godinë ose ndërtesë
- Instalimi i një objekti gjenerues FV në çati kërkon **pëlqimin e të gjithë pronarëve të tjerë** të pronës së përbashkët (godinës ose ndërtesës) dhe një marrëveshje për kompensimin.
- Përfaqësuesi është **përgjegjës** për **funksionimin** dhe **mirëmbajtjen** e objekteve të prodhimit
- Parimet e **shpërndarjes** së energjisë elektrike (ndërmjet pronarëve) të prodhuar nga një impiant gjenerimi FV (marrëveshja e pronarëve)
- Furnizuesi do të nënshkruajë kontrata furnizimi me të gjithë konsumatorët prodhues që veprojnë së bashku në ndërtesë me kapitujt përkatës që rregullojnë vetëkonsumin



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Faleminderit

Zyra e Rregullatorit për Energji
Korrik 2022, Prishtinë

www.ero-ks.org